



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 05.09.2016

Ref.: 781/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 44-të, të mbajtur më 25 Gusht 2016, mori:

V E N D I M

I. Nuk riakreditohen programet e studimit të BPrAL Kolegji "Dukagjini":

- Juridik, LLB, 240 ECTS;
- Menaxhment dhe Informatikë, BA 180 ECTS.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji "Dukagjini" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

| Nr. | Programi i studimit | Niveli | ECTS | Bartësit e Programit |
|-----|----------------------------|--------|------|--|
| 1 | Juridik | LLB | 240 | Agim Shaqiri, Mitasin Beqiri, Rezak Jakupi |
| | Menaxhment dhe Informatikë | BA | 180 | Hamit Aliu, Mefail Tahiri, Faruk Omeri |

AKA ka organizuar vizitë në BPrAL Kolegji "Dukagjini" më 08.08.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Peter Parycek; Prof. Dr. Dietmar Paier.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 25 Gusht 2016 ka shqyrtuar aplikacionin e BPrAL Kolegji "Dukagjini", dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me programin e studimit Juridik/ LLB, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë quar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Për sa i përket strukturës së programit të studimit, ekspertët kanë deklaruar se institucioni nuk ka ofruar asnjë informatë për konceptin didaktik të programit. Sipas EE, institucioni nuk ofron asnjë mbështetje institucionale për zhvillimin e aftësive mësimdhënëse për stafin akademik. Ekspertët kanë mësuar se problemet të cilat lidhen me organizimin dhe komunikimin ndërmjet institucionit të cilat janë adresuar edhe në vitin 2013, nuk janë zbatuar nga institucioni.

Për sa i përket stafit akademik, ekspertët kanë mësuar se institucioni numëron 9 anëtarë të rregullt të stafit akademik dhe 6 prej tyre me kohë të pjesshme. Megjithatë sipas ekspertëve këta profesorë shkojnë në Kolegjin Dukagjini vetëm për të dhënë ligjëratat e tyre. Një grup i profesorëve i cili bën vazhdimisht hulumtime apo punë për zhvillimin e programit të studimit Juridik, nuk ekziston fare. Po ashtu, përgatitja e stafit akademik sipas ekspertëve nuk është e fushës së juridikut, prandaj sipas tyre, stafi aktual akademik nuk është i përshtatshëm për të ligjëruar në programin Juridik të Kolegjit Dukagjini.

Për sa i përket hulumtimit, ekspertët nuk kanë pasur gati asnjë informacion për aktivitetet hulumtuese. Gjatë vizitës, asnjë dëshmi nuk i është ofruar ekspertëve për aktivitetet e hulumtimit. Plani për Zhvillimin e Hulumtimit nuk ekziston fare. Sipas ekspertëve, institucioni ka bashkëpunim të dobët ndërkombëtarë, dhe ani pse disa partnerë janë përmendur në Raportin e Vet Vlerësimit të institucionit, asnjë aktivitet i vetëm nuk është përmendur gjatë vizitës.

Përfundimisht, sipas Ekipit të Ekspertëve Programi Juridik nuk i përmbush kriteret minimale dhe prandaj nuk rekomandohet për ri/akreditim.

Në lidhje me programin e studimit Menaxhment dhe Informatikë, BA, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë quar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve, ekzistojnë dy probleme serioze të cilat kanë të bëjnë me lidhjen mes programit bachelor dhe master. Së pari, nuk ka asnjë modul i cili i dedikohet metodologjisë shkencore dhe metodave të hulumtimit. Së dyti, aftësitë e studentëve për gjuhën angleze nuk janë të zhvilluara në nivel të kënaqshëm. Ekspertët kanë deklaruar që ani pse caktimi i ECTS-ve është i përshtatshëm dhe i kuptueshëm, sipas tyre numri i orëve për ECTS është në nivelin më të ulët të ngarkesës. Për sa i përket konceptit didaktik, ekspertët mendojnë se një koncept i tillë nuk ekziston fare në Kolegjin Dukagjini. Edhe pas kërkesës së ekspertëve, institucioni dhe as personat përgjegjës të programit të studimit, nuk kanë mundur të shpjegojnë konceptin didaktik, përpos në terme të përgjithshme. Për sa i përket stafit akademik, ekspertët kanë mësuar se njohuritë dhe aftësitë e stafit për metodologjinë shkencore dhe hulumtimin nuk janë të kuptueshme. Ekspertët kanë deklaruar se asnjë nga stafi akademik i cili ka qenë pjesëmarrës në takime, nuk është i angazhuar në aktivitete të hulumtimit me financim të jashtëm. Po ashtu ekspertët kanë mësuar se edhe studentët janë rrallë herë të përfshirë në projekte të hulumtimit. Fokusi kryesor është projektet zhvillimore në bashkëpunim me kompanitë apo simulimi i rasteve reale dhe jo

hulumtimi. Përfundimisht, ekspertët kanë deklaruar se programi i studimit “Menaxhment dhe Informatikë” nuk përmbush kriteret minimale dhe prandaj nuk rekomandohet për ri/akreditim.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji “Dukagjini”
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë